



PROKURORIA E PËRGJITHSHME
Nr. 68/16 Prot.
Datë 03.03.2021.
DREJTORIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJE

Nr. 124/ Prot/A.SH

Në B.Curri me datë 26.02.2021.

Lënda: Dërgojmë raportin vjetor mbi gjëndjen e kriminalitetit dhe veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, për vitin 2020.

Drejtuar;

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME TIRANË
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.68 prot, datë 14.01.2021, bashkëlidhur ju dërgojmë raportin vjetor mbi gjëndjen e kriminalitetit dhe veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, për vitin 2020.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI PROKURORISË

ARTAN SHTRUNGZA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJË

RAPORT-VJETOR

MBI GJËNDJEN E KRIMINALITETIT

DHE VEPRIMTARINË E PROKURORISË PËR VITIN 2020

TROPOJË 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJË

Në Bajram Curri me datë 23.02.2021

RAPORT – VJETOR

MBI TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS DHE USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË NGA PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TROPOJË PËR VITIN 2020

DREJTUAR;

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Z. OLSIAN ÇELA

Raporti vjetor “Mbi gjëndjen e kriminalitetit për vitin 2020”, përpilohet në përmbushje të nenit 50 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, urdhërin nr.330 datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për përmbajtjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë”, udhëzimin nr.10/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, duke ja paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm për miratim.

Në këtë raport pasqyrohet në mënyre të plotë dhe të saktë, gjëndja e kriminalitetit, të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojin, shtrirjen, intensitetin dhe format e kriminalitetit në juridiksionin e Prokurorisë Tropojë, si dhe në vështrim të urdhërave dhe urdhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, ku janë përcaktuar drejtimet kryesore :

- Zbatimi i udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm (në dinamikë), me tregues dhe shpjegime për angazhimet e Prokurorisë, arritjet dhe problematikat.
- Zbatimi i Rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë për vitin 2020” miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësorë Tropojë ka ushtruar veprimtarinë e saj në respektim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Kuvendi i RSh, në vleraësim dhe të urdhërave e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në ushtrim të detyrave dhe përballimin e ngarkesës gjatë vitit 2020, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka patur efektivisht në përbërje 3 prokurorë dhe 1 oficer të policisë gjyqësore.

Është proceduar me urdhëra të brendshëm nga Drejtuesi i Prokurorisë, sipas përcaktimeve të ligjit 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në R.Sh" në lidhje me funksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve, për një zgjidhje me objektivitet të shpërndarjes së çështjeve, dhe krijimin e një klime të pamvarësisë së prokurorëve në ndjekjen e çështjeve, pa ju shmangur kontrollit ligjor të respektimit të procedurave hetimore.

Është vlerësuar në nivel të kënaqshëm, respektimi i standarteve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve, duke respektuar kuadrin ligjor të ngritjes së problematikave në çështje, nëpërmjet takimeve (mbledhjeve në dinamikë) trajtimit të rasteve të diskutuara nëpërmjet procedurave ligjore të pasqyruara në akte, në raport me drejtuesin apo me subjektet e përfshirë në çështje.

Referuar dinamikës së punës në tërësi, ngarkesës në hetim, por veçanërisht të asaj në gjykim, rastet e referuara janë trajtuar me kujdes dhe objektivitet, treguesit rezultojnë pozitiv në zgjidhjen e çështjeve si nga pikëpamja profesionale, por dhe treguesve të tjerë, të shpejtësise në hetim, politikave objektive dhe të drejta të raportit të kërkesave të prokurorisë dhe vendosjes së masave të sigurimit ndaj autorëve nga Gjykata, por dhe në aspektin e përfaqësimit në Gjykatë të çështjeve në htemel dhe qëndrimeve të mbajtura deri në masat e dënimit, të përfaqësimeve në Gjykatë.

Gjatë vitit 2020, duke pasë parasysh të dhënat statistikore dhe krahasuar ato me vitin 2019, por dhe me vitet e mëparshme, rezulton se ka pasë një zbutje të lehte të situatës së kriminalitetit në Bashkinë Tropojë, në të cilën ka juridiksion Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.

Nga të dhënat statistikore vërehet se ka thuhet te njëjtin numrer të veprave penale kundër jetës dhe shëndetit, veprave penale në fushën e pasurisë dhe ekonomi, veprave penale kundër mjedisit etj.

Për sa i përket luftës kundër kriminalitetit ka pasë një forcim të bashkëpunimit me strukturat e policisë së shtetit në Komisariatit e Policisë Tropojë dhe Drejtorinë e Policisë Qarkut Kukës, si dhe SHÇBA-së me qëllim identifikimin e veprave penale, autorësisë së tyre, kryrjen e veprimeve hetimore sa më të shpejta dhe efikase, identifikimin e fenomeneve të kriminalitetit, pjesëmarrjen e prokurorit në ngjarjet e rënda kriminale dhe ato kur prania e tij është e domosdoshme, kryerjen e analizave të përbashkëta në lidhje me fenomene të caktuara kriminale siç janë ato të kultivimit të narkotikëve të cilat për vitin 2020, kanë qenë në një numër relativisht të ulët që kanë rezultuar pa ndonjë organizim të strukturuar të veprimtarisë kriminale, por me raste individuale të kultivimit.

Si rezultat i organizmit të punës në bashkëpunim dhe me këto struktura janë finalizuar disa operacione gjatë të cilave janë arrestuar kultivues dhe shpërndarës të lëndëve narkotike. Konkretisht është finalizuar me sukses një operacion gjatë së cilit janë arrestuar 4 persona të

dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283 dhe 284 të Kodit Penal, si dhe dy operacione me dy të arrestuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 278, 283 dhe 284 të Kodit Penal.

Në bashkëpunim me strukturat e policisë janë referuar dhe janë në hetim disa procedime penale për vepra penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe krimit financiarë për të cilat vazhdojnë hetimet nga prokurori i caktuar nga drejtuesi i prokurorisë për hetimin e kësaj kategorie të veprave penale, pasi për shkaqe objektive që lidhen me numrin e ulët të prokurorëve nuk është bërë e mundur krijimi i seksionit të veçantë për hetimin e këtyre veprave penale, prandaj dhe bazuar në udhëzimet e prokurorit të përgjithshëm është caktuar një prokuror dhe një oficer i policisë gjyqësore për hetimin e veprave penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe krimit financiarë. Po ashtu është krijuar edhe rregjistri i hetimit pasuror i cili administrohet nga prokurori i caktuar për hetimin e grup veprave penale dhe një punonjësi i sekretarisë së prokurorisë.

Për sa i përket veprave penale të dhunes në familje, kundër fëmijëve dhe grave, gjatë vitit 2020 ka pasë disa raste të veprave penale të dhunës në familje të cilat nga prokurorët janë vlerësuar maskimalisht duke vendosur masa sigurimi të arrestit me burg ndaj autorëve të veprës penale si dhe duke kërkuar masa të ashpra dënimi për autorët e këtyre veprave penale. Në çdo rast viktimat e veprës penale janë asistuar nga psikologë, avokatë dhe kordinatori për ndihmë ndaj viktimave në prokurori si dhe në bashkëpunim me organizmat e tjera të mbrojtjes së viktimave të veprës penale dhe dhunës në bashki apo dhe qëndra të strehimit të viktimave të veprës penale.

Gjatë vitit 2020 nga prokurorët janë kërkuar edhe gjykimet me marrëveshje për vepra penale me masa të ulëta dënimi, si dhe janë kërkuar dënime alternative të parashikuara nga nenet 59 dhe 63 të Kodit Penal, për vepra penale me masa të ulëta dënimi dhe për shkak të rrezikshmërisë së ulët të personit apo veprës penale. Për vepra penale për të cilat dispozita parashikon dënime me burgim në maksimumin e dënimit deri në pesë vite burgim, apo dhe për masa dënimi të kërkuara me burgim deri në 5 vite, nga prokurorët janë kërkuar dënime alternative sidomos në ato raste kur vepra penale dhe autori i saj nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë, si dhe për vepra penale të kryera nga pakujdesia.

Po ashtu ka pasë një bashkëpunim shumë të mirë me Zyrën e Shërbimit të Provës, IEVP-së Tropojë dhe policisë lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale, për të cilat gjatë fazës së ekzekutimit nuk ka pasë problematika për t'u përmendur në këtë raport. Në çdo rast vendimet e dënimit janë vënë në ekzekutim nga prokurorët menjëherë sapo janë administruar vendimet e dënimit penal duke përcaktuar saktësisht objektin dhe procedurën e ekzekutimit.

Në bazë të ligjit nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë për të Mitur" është krijuar seksioni për të mitur, duke caktuar një Prokuror dhe një Oficer të Policisë Gjyqësore, duke patur parasysh ngarkesën e vogël për veprat penale me të mitur në juridiksionin që mbulon Prokuroria Tropojë. Çeshtjet me të mitur janë kryesisht të natyrës së drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt dhe perdomit

per konsum te leneve narkotike. Janë vlerësuar maksimalisht të gjitha rastet, në respektim të procedurave ligjore të Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Në asnjë rast nuk evidentohet pavlefshmëri aktesh procedurale, sa i përket respektimit të detyrimeve ligjore, të prezencës së avokatit, psikologut apo prindërve, si dhe të zbatimit të drejtë të caktimit të masave të sigurimit, pasi nga prokurorët dhe policia gjyqësore janë respektuar maksimalisht të drejtat e përcaktuara me ligj, lidhur me të miturit në konflikt me ligjin.

Gjate vitit 2020, ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Tropoje, jane rregjistruar procedime penale me te mitur ne konflikt me ligjin si me poshte;

- Jane rregjistruar 4 procedime penale me te mitur ne konflikt me ligjin, ne te cilat autore te mitur jane 5 persona te gjinise mashkullore dhe viktima te vepres penale te mitur 3 persona, 1 gjinia femerore dhe 2 gjinia mashkullore.
- Nuk ka pase asnje rast te hetimit te miturve ne konflikt me ligjin me mase sigurimi arrest ne burg.
- lidhur me afatet e hetimit per 1 procedim penal hetimet kane perfunduar per 1 muaj, per 1 procedim penal hetimet kane perfunduar per 2 muaj, per 1 procedim penal hetimet kane perfunduar per 1 muaj dhe per 1 procedim penal hetimet kane zgjatur me shume se 3 muaj.
- Per 1 te mitur eshte zbatuar masa masa e shmangjes nga ndjekja penale nga prokurori.
- Per 1 te mitur prokurori ka dhene paralajmerim me goje.
- Jane pushuar 2 procedime penale me autore te mitur, ehste derguar per gjykim 1 procedim penal me autore te mitur dhe eshte ne hetim 1 procedim penal me autore te mitur.

Bashkëpunim ligjor-procedural korrekt është mbajtur me drejtoritë prane Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, e së shumti me Drejtorinë e Marëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, sa i përket rasteve të ekstradimeve, apo dhe kërkesave të tjera procedurale lidhur me subjektet e ligjij për bashkëpunimin ndërkombëtarë me autoritetet e huaja dhe nuk ka pasë asnjë rast të problematikave negavtive për të theksuar në këtë raport.

Gjatë vitit 2020, ka pasë 2 raste të ekstradimit të shtetasve shqiptarë të kërkuyar nga autoritetet e huja, për kryerjen e veprave penale.

Rezultojnë dhe disa raste ekzekutime letër-porosish nga autoritetet e huaja, kryesisht notifikime njoftimesh personash, të cilat jane vleresuar maksimalisht duke proceduar në mënyrë të shpejtë për vënien e tyre në ekzekutim.

Gjatë vitit 2020, është rritur aksesit në të dhënat e databazeve shtetërore për administrimin në kohë të shpejtë të të dhënave personale dhe informacioneve të tjera me qëllim rritjen e shpejtësisë dhe efikasitetin e hetimeve.

Analiza e punës së organit të Prokurorisë në përgjithësi dhe asaj në veçanti të çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqësore, do ta realizonim duke ju referuar të dhënave statistikore 1-vjeçare që analizojmë pra vitit 2020.

Volumi i akteve të referuara (kallzime penale nga shërbimet e policisë, nga Institucionet dhe qytetarët).

Në zyrën e regjistrit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropjë janë gjatë vitit 2020 janë regjistruar 315 materiale kallëzuese, nga të cilat 221 materiale kallëzuese janë referuar nga sektorët e shërbimeve të Pol.Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Tropjë, 8 materiale kallëzuese nga policia pyjore, 3 materiale kallëzuese nga policitë e tjera, 8-materiale kallëzuese nga Institucionet dhe 75 materiale kallëzuese nga qytetarët.

Gjatë vitit 2020 rezulton një rritje e numrit të materialeve kallëzuese të referuara dhe regjistruara në prokurori në krahasim me vitin 2019, konkretisht me 43 materiale kallëzuese me shumë gjatë vitit 2020.

Evidencë e Refererimeve dhe kallëzimeve të regjistruara në Prokurori

Viti	Referime nga shërbimet e policisë	Kallzime nga Institucionet	Kallzime nga shtetasit dhe vepra mbi ankimin e të dëmtuarit	Gjithsej
2019	133	13	126	272
2020	232	8	75	315

Të gjitha rastet e akteve të referuara apo kallëzimeve të paraqitura janë trajtuar me përgjegjësi, duke i evidentuar në regjistrat përkatës, duke marrë vendime përkatës ligjorë, regjistrimi apo mosfillimi të çështjes penale sipas rastit.

Gjatë vitit 2020, ka pasë një numër më të madh të vendimeve të mosfillimit të marra nga porokurorët për materialet kallëzuese të trajtuara krahasuar me vitin 2019. Numri i madh i materilave kallëzuese lidhet edhe me problematikat e shkaktuara gjatë periudhës së pandemisë dhe masave të marra, ku për një periudhë kohe gjatë fillimit të vitit 2020 për shkak të masave të marra ka qenë i ndaluar për sa është e mundur kontakti me palët e përfshira në proces. Gjatë kësaj periudhe por dhe në vijim në shumë raste policisa gjyqësore pranë komisarariatit të policisë ka kryer veprimet e para hetimore dhe ka përcjellë materialin kallëzues në prokurori me mungesa të theksuara të veprimeve procedurale të cilat pas kryejres së verifikimeve kanë rezultuar se nuk përmbajnë elementë të veprave penale. Në çdo rast vendimet e prokurorieve u janë njoftuar palëve të ineteresuara duke arsyetuar vendimarrjen dhe të derjtat e anonimimit ndaj vendimeve.

Konkretisht gjatë vitit 2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 128 materiale kallëzuese në bazë të nenit 290/-291/ të K.Pr.Penale (40 vendime mosfillimi me shumë se gjatë vitit 2019 ku është venosur mosfillimi i procedimit penal për 88 materiale kallëzuese).

Gjatë vitit 2020 është vendosur regjistrimi i procedimit penal për 167 çështje penale (14 procedime penale më pak se vitin 2019, gjatë të cilit janë regjistruar 181 procedime penale).

Gjatë vitit 2020 ka pasë rënie të procedimeve penale të regjistruar me rreth 8%, krahasuar me vitin 2019.

Gjatë vitit 2020 janë regjistruar 167 procedime penale, janë mosfilluar 128 materiale kallëzuese dhe 20 materiale kallëzuese kanë mbetur në proces verifikimi pa u përfunduar gjatë vitit 2020 por që janë përfunduar gjatë vitit 2021.

Viti	Referime kallzime	Mosfilluar	Regjistruar
2019	272	88	181
2020	315	128	167

Më qartë veprimtaria e Prokurorisë do të rezultojë duke analizuar treguesit sipas dinamikës së trajtimit gjatë hetimeve dhe vendimarrjes referuar dhe praktikës procedurale që ndiqet, nga momenti i konstatimit të veprave penale nëpërmjet vend-ngjarjeve, kallzimeve penale etj, trajtimit në aspektin ligjor, shpejtësisë në hetim etj, që të krijonim një tablo sa më të qartë të pasqyrimin të rezultateve apo mangësive dhe problematikave të evidentuara.

MOSFILLIMET

Është vendosur mosfillimi i procedimit penal në bazë të neneve 290/ dhe 291/ të K.Pr.Penale, për 128 materiale kallëzuese.

Sa i përket tendencës të natyrës së veprave penale të referuara, vendimeve të mosfillimit rezultojnë në numër të konsiderueshëm si më poshtë :

Veprat penale të drejtuar kundër jetës së personit dhe shëndetit kreu II.

Gjatë vitit 2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 42 materiale kallëzuese.

Nga pjesa më e madhe janë vepra penale të parashikuara nga neni 84 të Kodit Penal, të cilat janë mosfilluar pasi nga materiali kallëzues ka rezultuar se nuk plotësojnë elementet e veprës penale ose dhe në raste kur i dëmtuari është tërhuqur nga ndjekja penale, si dhe neni 90 i kodit penal, duke orinetuar personat e dëmtuar që të paraqesin kërkesë padi në gjykatë në cilësinë e të dëmtuarit akuzues ose që janë mosfilluar për shkak se personi i dëmtuar është tërhuqur nga ndjekja penale.

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike kreu III.

Gjatë vitit 2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 51 materiale kallëzuese.

Kryesisht vendimet e mosfillimit kanë qenë për vepra penale të parashikuara nga nenet 150, 151 të kodit penal të cilat nga materialiet e para kallzuese ka rezultuar se jemi përpara kryerjes së veprave penale siç janë rastet e djegjeve të banesave nga energjia elektrike apo dhe dëmtime të pronës me velra të vogala për të cilat prokurororët kanë vendosur mosfillimin e procedimit penal,

duke orientuar personat e dëmtuar që të paraeqesin padi civile në gjyketë për të kërkuar pagimin e dëmit të shkaktuar.

Vepra penale kundër mjedisit, kreu IV;

Gjatë vitit 2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 4 materiale kallezues, për veprat penale të parashikuara nga nenet 204 dhe 205 të Kodit Penal, për të cilat nga materialet kallëzuese të mbajtura nga policia gjyqësore ka rezultuar se nuk jemi përpara kryerjes së veprës penale por të kundrvatjes administrative. Në çdo rast vendimi i mosfillimit është dërguar për njoftim personit të interesuar dhe bashkisë Tropojë për marrjen e masave administrative përkatëse.

Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, kreu VIII;

Gjatë vitit 2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 25 materiale kallëzuese. Kryesisht vendimi i mosfillimit për këtë grup veprash penale është vendosur për vepra penale të parashikuara nga neni 291 të kodit penal si dhe neni 277 të kodit penal, për të cilat por dhe materialet e tjera nga materiali kallzues ka rezultuar se nuk plotësohen elemnetët e veprës penale.

Vepra penale kundër drejtësisë, kreu IX;

Gjatë vitit 2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 4 materiale kallëzuese, 2 për veprën penale të parashikuar nga neni 305 i kodit penal dhe dy materiale kallëzuese për veprën penale të parashikuar nga neni 321 të Kodit Penal, pasi nga materiali kallzues i mbajtur ka rezultuar se nuk jemi përpara kryerjes së veprës penale..

Nuk ka pasë mosfillime të procedimeve penale për grup veprat e tjera penale gjatë vitit 2020.

Në të gjitha rastet, në arsyetimin e vendimeve të mosfillimit është bërë arsyetimi i faktit dhe rrethanave që kanë çuar prokurorët në marrjen e vendimit si dhe orientimi i personave të dëmtuar apo kallëzuesve për t'ju drejtuar Gjykatës për raste konkrete me padi civile, apo ankim direkt në Gjykatë sipas nenit 59 të K.Pr.Penale.

Në të gjitha rastet e mosfillimit të çështjeve janë bërë njoftimet e vendimeve të mosfillimit palëve të interesuara gjë që evidentohet si nga korespondenca e shkresës ashtu dhe kopjet e vendimeve të konfirmuara dhe të administruara në fashikujt përkatës.

Duhet evidentuar fakti se një pjesë e madhe e kallzimeve për të cilat është vendosur mosfillimi, janë kryer verifikime faktesh rrethanash apo administrim dokumentash, duke argumentuar plotësisht shkaqet e mosfillimit.

- Pra referuar evidencës së mësipërme rezulton se është bërë një punë e mirë dhe cilësore në lidhje me trajtimin e materialeve fillestare, ku nuk rezultojnë ankimime të vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedime penale.
- Duhet evidentuar fakti se është respektuar afati 15-ditor (*sipas ndryshimeve ligjore me ligjin nr.35/2017*)
- Po ashtu duhet evidentuar se rezultojnë referime të akteve me mangësi (të dukshme) nga policia gjyqësore, apo raste të konflikteve të pronësisë që kanë të bëjnë me administrim të praktikave administrative apo gjyqësore për të bërë një konkludim të saktë në vendim, si dhe vonesat në konfirmimet e akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, gjë që ka bërë që në disa raste të urdhërohet regjistrimi i materialeve kallëzuese, në pritje të administrimit të akteve të ndryshme.

ÇËSHTJE PENALE TË REGJISTRUARA DHE HETUARA.

- Në vitin 2020 janë regjistruar gjithsej 167 procedime penale.
- Nga vitit 2019 jane mbartur ne hetim 59 procedime penale.
- Ka ardhë me transferim nga prokuroritë e tjera 8 procedime penale.
- Gjatë vitit 2020, gjithsej në hetim procedime penale të mbartura nga viti 2019 dhe ato të rregjistruara dhe ardhura me transferim **gjatë vitit 2020 kanë qenë në total 234 procedime penale.**
- Pra për vitin 2020 rezultojnë gjithsej të hetuara 234 procedime penale.
- Kanë përfunduar hetimet gjithsej për 154 procedime penale.
- Kanë mbetur në hetim pa përfunduar 80 procedime penale.

Gjatë vitit 2020, ka pasë rënie me 7 procedime penale të rregjistruar krahasuar me vitin 2019, si dhe rënie me 8 procedime penale të hetuara në total gjatë vitit 2020.

Evidencë e çështjeve të regjistruara dhe hetuara

Viti	Mbartur nga viti para -ardhës	Regjistruar	Gjithsej Hetuar	Përfunduar
2019	60	182	242	183
2020	59	175	234	154

Gjatë vitit 2020 janë rifilluar hetimet për procedimet penale të pezulluara për 84 procedime penale të viteve të mëparshme, të cilat janë rifilluar për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale,

të cilat janë pushuar me vendim nga prokurorët apo janë dërguar me kërkesë për pushim në gjykatë, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

DREJTIMET, SHTRIRJA DHE TENDENCAT E PËRHAPJES SË VEPRAVE PENALE NË PËRGJITHËSI DHE /OSE GRUP VEPRAVE PENALE NË VEÇANTI.

Sa i përket tendencës së natyrës kriminalitetit, të përhapjes së veprave penale në përgjithësi apo me grup veprash penale të veçanta rezulton se veprat penale me një shtrirje dhe përhapje më të madhe janë ato të :

Veprat penale të drejtuara kundër jetës së personit dhe shëndetit kreu II.

- Janë rregjistruar gjatë vitit 2020 gjithësej 12 procedime penale;
- Nga vitit 2019 jane mbartur gjithësej 4 procedime penale;
- Gjatë vitit 2020 kanë qenë në hetim gjithësej 16 procedime penale.

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike kreu III.

- Janë rregjistruar gjatë vitit 2020 gjithësej 77 procedime penale.
- Nga viti 2019 jane mbartur gjithësej 30 procedime penale;
- Gjatë vitit 2020 kanë qenë në hetim gjithësej 103 procedime penale.

Vepra penale kundër mjedisit, kreu IV;

- Janë rregjistruar gjatë vitit 2020 gjithësej 9 procedime penale.

- **Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, vepra penale që çënojnë marrëdhënjet me shtete e tjera dhe vepra penale me qëllime terrorsite të parashikuara nga krerët V, VI, VII, të kodit penal nuk ka patur gjatë vitit 2020;**

Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, kreu VIII;

- Janë rregjistruar gjatë vitit 2020 gjithësej 63 procedime penale.
- Nga viti 2019 jane mbartur gjithësej 25 procedime penale;
- Gjatë vitit 2020 kanë qenë në hetim gjithësej 85 procedime penale.

Vepra penale kundër drejtësisë, kreu IX;

- Janë rregjistruar gjatë vitit 2020 gjithësej 2 procedime penale.

Vepra penale që prekin sistemin e zgjedhjeve, kreu X, gjatë vitit 2020 nuk ka pasur.

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE.

(Personat në hetim, masa sigurimit, pushimet, pezullimet dhe të dërguara për gjykim)

Kanë përfunduar hetimet dhe është konkluduar në vendim përfundimtar për 154 çështje penale për vitin 2020, duke mbartur në hetim 60-çështje penale për vitin 2021.

Rezulton se nga 154- çështje të përfunduara:

- 57- çështje janë dërguar për gjykim,
- 35 -çështje janë pushuar,
- 56- çështje janë pezulluar,
- 6-çështje janë transferuar për kompetence,

Tabelë përmbledhëse

Mbartur nga 201	Regjistruar ne 2020	Hetuar	Gjyg	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	Mbartur në hetim në-2020
59	175	234	57	35	56	6	80

PERSONA NËN HETIM, DHE MASAT E SIGURIMIT

Regjistruar emri si person nën hetim.

Në këto proçedime penale rezulton se është regjistruar emri për 130- persona me cilësinë e të dyshuarit për një vepër penale në urdhërin e regjistrimit, pra me cilësinë ndaj të cilëve zhvillohen hetime.

- Kanë përfunduar hetimet për 84- persona dhe janë mbartur në hetim 42 persona nën hetim dhe 4 të pandehur, për vitin 2021.
- Për 64-persona është njoftuar akuzat dhe janë dërguar për gjykim,
- për 7 - persona nën hetim është vendosur transferimi i proçedimeve penale,
- për 11 - persona është vendosur pushimi i çështjes penale në ngarkim të tyre,
- për 2- persona nën hetim është vendosur pezullimi i hetimeve,

Masat e sigurimit .

- Janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore 30 persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale.
- Janë ndaluar me urdhër të prokurorit 3 të dyshuar për kryerjen e vprave penale.
- Gjithësej të arrestuar/ndaluar kanë qenë 33 persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale.
- Janë kërkuar në gjykate vendosja e masës së sigurimit arrest në burg në mungesë për 5 persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale, për të cilët gjykata ka pranuar kërkesat.

- Është kërkuar vleftësimi i arrestit në flagrancë dhe ndalimit për 33 persona të dyshuar.
- Gjykata për 33 - raste ka vleftësuar të ligjshëm arrestimet/ndalimet.

Janë kërkuar masa sigurimi personal si më poshtë;

- 20-të dyshuar është kërkuar masa e sigurimit “arrest në burg” sipas nenit 238 të K.Pr.Penale,
- 4-të dyshuar “arrest në shtëpi” sipas nenit 237 të K.Pr.Penale,
- 9-të dyshuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Pol/Gjyqësore” sipas nenit 234 të K.Pr.Penale.
- Për 5- të dyshuar masa e sigurimit “arrest në burg në mungesë”.

Nga Gjykata është vendosur caktim masë sigurimi për :

- 18 - persona “arrest në burg”,
- 6 - persona “arrest në shtëpi”,
- 9- persona masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në Pol/Gjyqësore”.
- 5 -persona masa e sigurimit “arrest në burg”, në mungesë.

Janë apeluar nga prokurori 2 vendime të gjykatës për zbutjen e masës së kërkuar nga prokurori, për të cilat gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka zbutur kërkesën e prokurorit për llojin e masës së sigurimit..

Janë ushtruar 3 ankime kundërshtuese ndaj ankimeve të arrestuarave që kanë kërkuar zbutjen e masës së sigurimit të kërkuar nga prokurori dhe në 3 rastet gjykata e apelit ka lënë në fuqi kërksat e prokurorit.

CËSHTJE TË DËRGUARA NË GJYKATË

- Pas përfundimit të hetimeve gjatë vitit 2020, janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë 57-procedime penale, me 64 - të pandehur, ndër të cilët 15 me masë sigurimi arrest në burg.
- Janë mbartur nga viti 2019 në gjykim 27 procedime penale me 40 të pandehur, ndër të cilët me 1 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.
- Kanë qenë në gjykim gjatë vitit 2020 gjithsej 84 procedime penale, me 104 të pandehur, ndër të cilët 16 me mase sigurimi arrest në burg.

Duke ju referuar veprave penale për të cilën janë akuzuar e dërguar për gjykim të pandehurit, rezulton si më poshtë :

Veprat penale të drejtuar kundër jetës së personit dhe shëndetit kreu II.

- Dërguar për gjykim 7 procedime, me 7 të pandehur, me 5 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.

- Mbartura nga viti 2019 në gjykim 1 procedim penal me 1 të pandehur.
- Gjithesëj në gjykim 8 procedime penale me 8 të pandehur, me 5 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike kreu III.

- Dërguar për gjykim 30 procedime, me 35 të pandehur, me 2 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.
- Mbartura nga vitit 2019 në gjykim 14 procedime penale, me 18 të pandehur, me 1 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.
- Gjithesëj gjatë vitit 2020 në gjykim 44 procedime penale, me 53 të pandehur, me 3 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.

Vepra penale kundër mjedisit, kreu IV;

- Dërguar për gjykim 1 procedim, me 1 të pandehur.
- Mbartura nga viti 2019 në gjykim 2 procedim penale, me 2 të pandehur.
- Gjithesëj në gjykim 3 procedime penale, me 3 të pandehur.

Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, kreu VIII;

- Dërguar për gjykim 17 procedime, me 18 të pandehur, me 7 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.
- Mbartura nga viti 2019 në gjykim 9 procedime penale, me 1 të pandehur.
- Gjithesëj në gjykim 26 procedime penale, me 31 të pandehur, me 7 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.

Vepra penale kundër drejtësisë, kreu IX;

- Dërguar gjatë vitit 2020 për gjykim 2 procedime penale me 3 të pandehur.
- Gjithesëj në gjykim 2 procedime penale me 3 të pandehur.

Vepra penale që prekin sistemin e zgjedhjeve, kreu X;

- Mbartur nga viti 2019 në gjykim 1 procedim penal me 6 të pandehur.
- Gjithesëj gjatë vitit 2020 në gjykim 1 procedim penal me 6 të pandehur.

Forma e gjykimit.

- Janë dërguar gjykatës kërkesat për miratimin e marrëveshjes së pranimit të fajësise për 4 procedime penale dhe gjykata ka vendosur miratimin e marrëveshjes për 4 procedime penale.

- Janë gjykuar me gjykim të shkurtuar 42 procedime penale dhe me gjykim në mungesë 1 procedim penal.

ÇËSHTJE PENALE TË PËRFUNDUARA GJYKIMI PËR VITIN 2020

- Gjatë vitit 2020, ka përfunduar gjykimin për 43-procedime penale, me 56-të pandehur, nga të cilët 5-të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.
- Kanë mbetur në gjykim 41 procedime penale, me 48 të pandehur me 11 të pandehur me masë sigurimi arrest në burg.

Nga Prokuroria ;

- Për 2 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobë.
- Për 5 të pandehur dënim mesatarë,
- Për 46 të pandehur është kërkuar dënim alternativ aplikimi i nenit 59 K.Penal.
- Për 1 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes.
- Për 2 të pandehur është kërkuar tërheqje e akteve nga gjykata,

Nga Gjykata ;

- Për 2 të pandehur është dhënë dënim me gjobë.
- Për 1 të pandehur është dhënë dënimi në minimum të dispozitës.
- Për 5 të pandehur është dhënë dënim mesatarë.
- Për 45 të pandehur është dhënë dënim alternativ aplikimi i nenit 59 K.Penal.
- Për 1 të pandehur është vendosur pushimi i çështjes.
- Për 2 të pandehur është vendosur kthimi i akteve prokurorit,

Është ushtruar ankimi nga prokurori për 1 vendim të gjykatës që ka vendosur pafajësi dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pafajësi neni 291 të K.Penal. Është ushtruar ankimi kundërshtues për 1 rast të ankimit të vendimit të dënimit të dhënë nga gjykata dhe çështja vijon të jetë në gjykim në apel.

Siç rezulton dhe nga të dhënat statistikore nuk ka pasë diferencim të madh lidhur me kërkesat e prokurorit për llojin apo masën e dënimit penal dhe pergjithësisht dënimet e dhëna nga gjykata janë në harmoni me kërkesat e prokurorëve.

Evidentojmë faktin që një pjesë e madhe e dënimeve me kusht (pezulluar ekzekutimin e dënimit me burg neni 59 K.P) dhe detyrimit për të bërë një punë me interes publik (neni 63 te K.P) kanë të bëjnë me vepra penale të parashikuara nga nenet 291 dhe 199/a/1 të K.Penal, 199/a, si dhe vepra të tjera të lehta penale.

Në këtë vështrim janë analizuar dhe qëndrimet për apelim me këtë raport ndryshimesh të kërkesave dhe dhënies së vendimeve.

Ankimet në Gjykatën e Apelit

Është ushtruar ankim nga prokurori për 1 vendim të gjykatës që ka vendosur pafajësi dhe gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për pafajësi neni 291 të K.Penal.

Është ushtruar ankim kundërshtues për 1 rast të ankimit të vendimit të dënimit të dhënë nga gjykata dhe çështja vijon të jetë në gjykim në apel.

Janë apeluar nga prokurori 2 vendime të gjykatës për zbutjen e masës së kërkuar nga prokurori, për të cilat gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka zbutur kërkesën e prokurorit për llojin e masës së sigurimit.

Janë ushtruar 3 ankime kundërshtuese ndaj ankimeve të arrestuarave që kanë kërkuar zbutjen e masës së sigurimit të kërkuar nga prokurori dhe në 3 rastet gjykata e apelit ka lënë në fuqi kërksat e prokurorit.

PROCEDIMET PENALE TË PUSHUARA

Gjatë këtij viti nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tropojë është vendosur pushimi për 35-procedime penale.

Po ashtu janë rifilluar hetimet për 84 procedime penale të viteve të mëparshme të pezulluara, të cilat janë rifilluar dhe pushuar me vendim nga prokurori apo paraqitur kërkesat gjyqësore për pushimin e hetimeve për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

- Për 11-çështje është vendosur pushimi në Prokurori (kundravajtjet penale, dhe me heqje dorë)
- Për 24 -çështje është kërkuar miratimi i kërkesës për pushim në Gjykatë.

Duke ju referuar statistikës rezulton se në total për çështjet që kanë qenë në hetim të dërguara për pushim, së bashku me ato të rifilluara dhe të dërguara për pushim për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale :

Për 19-procedime penale është vendosur pushimi në bazë të nenit 328/a (fakti nuk ekziston) të K.Pr.Penale.

Për 13-procedime penale është vendosur pushimi në bazë të nenit 328/dh të K.Pr.Penale (për mungesë provash).

Për 87 - procedime penale është vendosur pushimi në bazë të nenit 328/c – 286 K.Pr.Penale (heqja dorë nga ankimi) kryesisht për nenet 275, 89, 84 Kdoti Penal, si dhe për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Duke ju referuar grup veprave penale për të cilat është rregjistruar procedimi rezulton se është vendosur pushimi si më poshtë :

Veprat penale të drejtuar kundër jetës së personit dhe shëndetit kreu II.

- Gjatë vitit 2020, janë pushuar hetimet për 1 procedim penal.

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike kreu III.

- Gjatë vitit 2020, janë pushuar hetimet 84 procedime penale. (së bashku me procedime penale të pushuar për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale).

Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, kreu VIII;

- Gjatë vitit 2020, janë pushuar hetimet për 37 procedime penale.

Vepra penale kundër drejtësisë, kreu IX;

- Gjatë vitit 2020, janë pushuar hetimet për 1 procedim penal.

Dosjet e pushuara që kanë qenë në hetim gjatë vitit 2020, kanë qenë kryesisht për vepra penale të parashikuara nga nenet 290/1, 275, 150, 151 të Kodit Penal. Po ashtu nga numri total prej 119 procedimeve penale të pushuara rezulton se 84 procedime penale janë procedime penale të rifilluara nga procedimet e pezulluara në vite, të cilat janë pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Po ashtu duhet theksuar si problematikë për dojet e pushuara se për shkak të largësisë me Tiranën si dhe mungesës së shumë ekspertëve të fushave të ndryshme në Tropojë shumë herë prokurorët detyrohen të rregjistrojnë procedime penale të cilat në momentin e rregjistrimit nuk mund të konstatohet se veprimi ose mosveprimi i plotëson elementet e veprës penale pa kryer më përpara ekspertimet përkatëse teknike kriminalistike, siç jemi përpara rastit të veprave penale në fushën e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugorë, mjekësisë ligjore, etj. Për shkak të largësisë, vonesës në kthimin e akteve të ekspertimit dhe mungesës së ekspertëve mjekoligjorë dhe të tjerë, jemi të detyruar të rregjistrojmë procedimin penal pasi deri në ardhjen e aktit të ekspertimit kalojnë afatet për të vendosur mosfillimin e procedimit penal. Po ashtu një pjesë e mirë e procedimeve penale janë procedime të rregjistruara për vepra penale që ndiqen mbi bazën e ankimit të demtuarit të cilët më pas kanë terhequr ankimin e bërë nga ana e tyre.

PROCEDIMET PENALE TË PEZULLUARA

Është vendosur pezullimi i hetimeve në bazë të nenit 326/1,2 të K.Pr.Penale për 56- procedime penale të cilat janë të ndara me grup veprash, si më poshtë :

Veprat penale të drejtuara kundër jetës së personit dhe shëndetit kreu II.

- Gjatë vitit 2020, janë pezulluar hetimet për 3 procedime penale

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike kreu III.

- Gjatë vitit 2020, janë pezulluar hetimet për 21 procedime penale.

Vepra penale kundër mjedisit, kreu IV;

- Gjatë vitit 2020 janë pezulluar hetimet për 6 procedime penale.

Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, kreu VIII;

➤ Gjatë vitit 2020 janë pezulluar hetimet për 26 procedime penale.

Procedimet penale të pezulluara janë kryesisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 134, 284 dhe 275 të Kodit Penal.

Në të gjitha rastet është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore si dhe deleguar veprime specifike, dhe në përfundim bazuar dhe në relacionin e oficerëve të policisë gjyqësore është vendosur pezullimi i hetimeve.

Në kuptimin e figurave të krimit të këtyre grup veprave penale duhet nënvizuar se për nenin 134 dhe 284 të Kodit Penal rezulton pjesa më e madhe e tyre.

PROCEDIMET PENALE TË TRANSFERUARA

Është vendosur transferimi për kompetencë tokësore dhe lëndore për 6 - procedime penale të cilat janë transferuar për kompetencë tokësore apo dhe lëndore hetimi në prokuroritë e tjera.

Ka pasë një rast të shpalljes së moskompetencës nga prokurori i cili pas trajtimit të konfliktit të kompetencës, Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur kthimin për hetim për kompetencë në Prokurorinë Tropojë.

Pra evidentojmë faktin që vendimet kanë qenë të arsyetuara dhe të bazuara në dispozitat proceduriale për kompetencën.

SHPEJTËSIA ME HETIMET PARAPRAKE DHE AFATET E PARABURGIMIT

Nga treguesit kryesor të veprimtarisë së punës së Prokurorëve dhe trupës së of/pol/Gjyqësore të Prokurorisë dhe shërbimeve pranë Komisarariatit të Policisë Tropojë, është shpejtësia e veprimeve hetimore në hetimet paraprake e cila ka të bëjë në respektimin e dispozitave proceduriale penale për afatet e hetimit dhe në veçanti ato të paraburgimit me të pandehur të arrestuar .

Rezulton se përgjithësisht janë respektuar kriteret e afateve të hetimit.

Rezulton se për vitin 2020, gjatë hetimeve paraprake është kërkuar zgjatje afati hetimor për 22- çështje penale nga 234-çështje të hetura gjithsej.

Konkretisht është kërkuar zgjatje e afatit të hetimit për:

- 15-procedime penale me 16 te pandehur është vendosur zgjatje afati deri në 3 muaj,
- 4-procedime është vendosur zgjatje afati deri në 6 muaj.
- 2 –procedime penale, me 2 të pandehur është vendosur zgjatja e afatave nga 6-9 muaj.
- 1- procedim penal me 1 te pandehur është vendosur zgjatja e afatve deri në 1-vit.

Në lidhje me afatet e paraburgimit nuk ka asnjë rast të kalimit të këtyre afateve , për rrjedhojë nuk kemi asnjë kërkesë drejtuar Gjykatës për zgjatjen e afatit të paraburgimit.

Duhet evidentuar fakti se kryesisht gjatë vitit 2020, zgjatjet kanë ardhë si shkak dhe pasojë e pa mundësisë për kryerjen e veprimeve hetimore në kohë dhe për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19 dhe masat e marra nga institucionet shtetërore për parandalimin e sajë. Po ashtu duhet evidentuar se një shkak tjetër është edhe vonesat në kthimin e akateve të ekspertimeve me natyrë teknike kriminalistike si dhe përgjigjet nga kompanitë telefonike celulare apo dhe institucionet e tjera.

EKZEKUTIMI I VENDIME PENALE

Gjate vitit 2020, jane nxjerre nga prokuroret 33 urdhera ekzekutimi te masave te sigurimit personal. Nga keto jane ekzekutuar 33 urdhera ekzekutimi per masa sigurimi me te arrestuar apo ndaluar.

Jane nxjerre nga prokuroret 5 urdhera ekzekutimi te masave te sigurimit "Arrest me burg", ne mungese, nga te cilat jane ekzekutuar 3 urdhera ekzekutimi dhe kane mbetur pa ekzekutuar 2 urdhera ekzekutimi.

Jane nxjerre 38 urdhera ekzekutimi per denime alternative te dhena nga gjykata te cilat jane vene ne ekzekutim nga Zyra e Permbarimit Gjyqesore Tropoje per te gjithë urdherat e ekzekutimit.

Jane nxjerre 4 urdhera ekzekutimi me burgim nga te cilat jane ekzekutuar 3 urdhera ekzekutimi dhe ka mbetur pa ekzekutuar 1 urdher ekzekutimi.

Jane nxjerre 2 urdhera ekzekutimi me gjobe, nga te cilat nuk eshte ekzekutuar asnje urdher ekzekutimi nga Zyra e Permbarimit Gjyqesore Tropoje nga te cilat nuk eshte ekzekutuar asnje urdher ekzekutimi nga Zyra e Permbarimit Gjyqesore Tropoje.

Jane nxjerre 39 urdhera ekzekutimi per shpenzime proceduriale nga te cilat nuk eshte ekzekutuar asnje urdher ekzekutimi nga Zyra e Permbarimit Gjyqesore Tropoje.

Eshte nxjerre 1 urdher ekzekutim mase mjekesore "Mjekim i detyruar ambulator", i cili eshte vene ne ekzekutim.

Jane nxjerre 2 urdhera per ekzekutimin e vendimeve penale te gjykates per masa te denimeve plotesuese, te dhena nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tropoje, te cilat jane vene ne ekzekutim.

- Gjate vitit 2020 jane nxjerre gjithesej 124 urdhera ekzekutimi.
- Gjate vitit 2020, jane ekzekutuar gjithesej 80 urdhera ekzekutimi.
- Kane mbetur pa ekzekutuar gjithesej 44 urdhera ekzekutimi.

Veprimtaria dhe ngarkesa e Prokurorëve dhe Of/Pol/Gjyqësorë.

Por për të qartësuar veprimtarin, punën individuale për çdo Prokuror dhe Of/Pol/Gjyqësore po paraqesim dhe treguesit për secilin në veçanti :

Prokurori Artan Shtrungza

Hetuar -	93 kallëzime penale,
Mosfillime -	32- kallëzime penale,
Rregjistruar -	61-procedime penale,
Dërguar në gjyq –	13 -proçedime penale
Pushuar –	05- proçedime penale
Pezulluar –	05 -proçedime penale
Transferuar -	01 -proçedim penal
Mbartur -	37- proçedime penale

Prokurori Artur Ismajlukaj

Hetuar -	93 kallëzime penale,
Mosfillime -	35- kallëzime penale,
Rregjistruar -	58-procedime penale,
Dërguar në gjyq –	15 -proçedime penale
Pushuar –	11- proçedime penale
Pezulluar –	18 -proçedime penale
Transferuar -	02 -proçedime penale
Mbartur -	12- proçedime penale

Prokurori Agim Dalipaj

Hetuar -	118 kallëzime penale,
Mosfillime -	64- kallëzime penale,
Rregjistruar -	54-procedime penale,

Dërguar në gjyq –	07 -proçedime penale
Pushuar –	07- proçedime penale
Pezulluar –	11 -proçedime penale
Transferuar -	02 -proçedime penale
Mbartur -	27- proçedime penale

Gjatë veprimtarisë së punës së Prokurorëve duhet evidentuar si ngarkesë dhe proçedimet penale për të cilat është vendosur pushimi për shkak parashkrimi gjithsej 84- vendime pushimi për shkak parashkrimi sipas nenit 66/ të K.Penal.

Duhet evidentuar dhe ngarkesa e **Of/Pol/Gjyqësore të seksionit të Prokurorisë Tropojë** e cila është perballuar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore Elton Hoxhaj.

Of/Pol/Gjyqësore Elton Hoxhaj ka hetuar 47 - çështje penale.

- Ka relatuar për dërgim për gjykim 16 procedime penale.
- Ka relatuar për pezullim 6 dosje penale.
- Ka relatuar për pushim 7 dosje penale.
- Ka përfudnuar 29 procedime penale.

Ka mbartur ne hetim 18 dosje penale.

Of/Pol/Gjyqësore seksioni i policisë së shtetit Artur Hykaj ka hetuar 17 - çështje penale.

- Ka relatuar për dërgim për gjykim 1 dosje penale.
- Ka relatuar për pezullim 3 dosje penale.
- Ka relatuar për pushim 4 dosje penale.
- Ka relatuar për transferim 1 dosje penale.
- Ka përfunduar hetimet për 9 procedime penale.
- Ka mbartur në hetim 8 procedime penale.

Of/Pol/Gjyqësore seksioni i policisë së shtetit Visar Ismalaj ka hetuar 22 - çështje penale.

- Ka relatuar për dërgim për gjykim 4 procedime penale.
- Ka relatuar për pezullim 8 dosje penale.
- Ka relatuar për pushim 6 dosje penale.
- Ka përfunduar hetimet për 18 procedime penale.
- Ka mbartur në hetim 4 dosje penale.

Of/Pol/Gjyqësore seksioni i policisë së shtetit Fatos Tahiri ka hetuar 23 - çështje penale.

- Ka relatuar për dërgim për gjykim 5 procedime penale.
- Ka relatuar për pezullim 3 dosje penale.
- Ka relatuar për pushim 1 dosje penale.
- Ka përfunduar hetimet për 9 procedime penale.
- Ka mbartur në hetim 14 dosje penale.

Of/Pol/Gjyqësore seksioni i policisë së shtetit Veton Progni ka hetuar 10 - çështje penale.

- Ka relatuar për pezullim 4 dosje penale.
- Ka mbartur në hetim 6 procedime penale.

Of/Pol/Gjyqësore seksioni i policisë së shtetit Sadik Kateshi ka hetuar 17 - çështje penale.

- Ka relatuar për dërgim për gjykim 2 procedime penale.
- Ka mbartur në hetim 15 dosje penale.

Ekstradimet dhe Letër-porositë

Një tjetër veprimtari që duhet evidentuar janë dhe kërkesat për ekzekutimin e letërporosive për marrjen e provave si dhe kërkesat për ekstradimin e personave të dënuar apo dyshuar.

Konkretisht rezulton se janë arrestuar 2 persona të shpallur në kërkim nga autoritetet kosovare të drejtësisë të cilët pas kryerjes së veprimeve procedurale dhe gjyqësore përfundimisht gjykata ka vendosur ekstradimin e tyre dhe në përfundim të procesit është realizuar ekstradimi.

Janë ekzekutuar 4 letërporosi nga jashtë për marrjen e provave, ndërsa është kërkuar marrja e provave nëpërmjet letërporosisë për 2 raste lidhur me nevojat e procedimeve penale.

Është paraqitur në gjykatë 1 kërkesë për njohjen e vendimit penal të huaj, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata.

USHTRIMI I ROLIT DHE KOMPETENCAVE TË DREJTUESIT TË PROKURORISË.

Në veprimtarinë e ndjekjes penale për çështjet e hetuara dhe të përfaqesuara në gjykim, një rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesit e Prokurorisë, që nga momenti i parë i vlerësimit të akteve të referuara për problematikën e rasteve drejtim regjistrimit të çështjeve penale, më pas të kontrollit në dinamikë, analizave për rastet e diferencuara, si dhe krijimit të marrëdhënieve me Prokurorët dhe Of/Pol/Gjyqësore, të seksionit të Prokurorisë dhe seksioneve dhe shërbimeve të Policisë, si dhe me Institucionet e tjera .

Gjate periudhës që analizojmë nga Drejtuesi i Prokurorisë janë studiuar të gjitha materialet kallëzuese dhe të referuara nga Policia Gjyqësore e ato me vendngjarje, duke organizuar punën për regjistrimin e çështjeve.

Urdhërat dhe udhëzimet e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, janë punuar dhe diskutuar për implementimin e tyre.

Është ushtruar kontroll në dinamikë të çështjeve penale gjatë hetimeve paraprake, janë evidentuar dhe kërkuar verbalisht veprime konkrete që duhet të kryhen.

Konkretisht është krijuar një klimë e mirë bashkëpunimi në përballimin e ngarkesës, ndarjen e çështjeve sipas shortit, duke respektuar proporcionalitetin, dhe në raste të veçanta për shkak ngarkese apo profilizimi të caktuar Prokurorë të ndryshëm janë ngarkuar me çështje të veçanta.

Referuar urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, janë nxjerrë disa urdhëra dhe udhëzime nga Drejtuesi i Prokurorisë.

MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET

Së pari raporti ligjor dhe korrektësia, ka shoqëruar marrëdhëniet me Institucionet e tjera ligjzbatuese, në veçanti me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Tropojë, si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Tropojë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Marrëdhëniet që burojnë për shkak të veprimtarisë dhe procedurave ligjore, të hetimit dhe përfaqesimit në gjyq, pra me Policinë dhe Gjykatën, janë vlerësuar si marrëdhënie bashkëpunimi si në aspektin organizativ ashtu dhe atë ligjor në respektim të kryerjes së detyrave në afate nga seksionet e Pol/Gjyqësore dhe shërbimet, ashtu dhe respektimin dhe korrektësinë në zhvillimin e seancave gjyqësore me Gjykatën.

Në disa raste është mbajtur qëndrim për problematika të ndryshme, të karakterit organizativ të punës, pa cënuar pamvarësinë e institucioneve.

1. GJYKATA

Nuk janë evidentuar raste të shtyrjes së seancave gjyqësore për mosparaqitjen e prokurorëve. Nga ana e gjykatës duhet vlerësuar bashkëpunimi me prokurorët për përballimin e ngarkesës në gjykim, si dhe organizmi i punës lidhur me njoftimin në kohë të datave të seancave gjyqësore, marrjen dhe përcjelljen në kohë të dokumentacionit.

Disa raste me zvarritje të proceseve janë evidentuar për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve në mujorin e parë dhe problematikave lidhur me komandimin e gjyqtarëve nga rrethet e tjera.

2. ZYRA SHËRBIMIT TË PROVËS.

Marredhënia e Prokurorisë me zyrën e shërbimit të provës, lidhet për shkak të trajtimit të rasteve të gjykimeve me objekt lirimet para kohe me kusht, pra ekzekutimit të këtyre vendimeve.

Në rastet e kërkuara nga prokurorët dhe Gjykata në aplikimin e dhënies së dënimeve me kusht sipas nenit 59 të K.Penal, përgjithësisht janë raportuar verifikimet me një raport, i cili ka shërbyer më pas për të vlerësuar kushtet dhe kriteret llojin e dënimit, dhe në 2-raste është kërkuar revokimi i dënimit me kusht.

Gjatë vitit 2020 nuk janë vërejtur problematika në ekzekutimin në kohë të dënimeve alternative dhe përmbylljen e raporteve përfundimtare të shërbimit të provës.

3. SHËRBIMET E POLICISË

Përgjithësisht është reflektuar një nivel shumë i mirë bashkëpunimi.

Është vlerësuar si e rëndësishme fazën e njoftimit të prokurorëve të gatshëm sipas grafikut për vepra penale të karakterit të rëndë, por dhe të problematikave ligjore gjatë veprimeve të para hetimore.

Për sa i përket luftës kundër kriminalitetit ka pasë një forcim të bashkëpunimit me strukturat e policisë së shtetit në Komisarriatin e Policisë Tropojë dhe Drejtorinë e Policisë Qarkut Kukës, si dhe SHÇBA me qëllim identifikimin e veprave penale, autorësisë së tyre, kryerjen e veprimeve hetimore sa më të shpejta dhe efikase, identifikimin e fenomeneve të kriminalitetit, pjesëmarrjen e prokurorit në ngjarjet e rënda kriminale dhe ato kur prania e tij është e domosdoshme, kryerjen e analizave të përbashkëta në lidhje me fenomene të caktuara kriminale siç janë ato të kultivimit të narkotikëve etj.

Në lidhje me materialet e referuara, shpesh evidentohen dhe mangësi të karakterit formal por dhe procedural.

- Duhet ngritur niveli profesional i policisë gjyqësore.
- Nga sektori i krimit ekonomik apo për vepra penale me natyrë korruptive, rezulton se nuk ka referime thelbësore për vepra penale në këtë fushë. Veprimet hetimore fillohen vetëm në rastet kur evidentohen nga të dhënat e dërguara nga agjensitë e tjera ligjzbatuese.
- Në rastet e referimit të veprave penale lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale, materialet referohen shumë të mangëta pa kryer verifikime lidhur me pasurinë e personave të kallezuar apo tjetër dhe janë në një numër shumë të ulët.

4. ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Duhen evidentuar dhe marrëdhëniet me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, në funksion të zbatimit të urdhërave dhe udhëzimeve.

Evidentojmë se nga nxjerrja e tyre kanë gjetur zbatim dhe ndikuar në mbarëvajtjen e veprimtarisë së Prokurorisë në hetimin e çështjeve dhe përfaqësimin në gjykim, por dhe drejtim aspektit organizativ.

Duhet evidentuar fakti i një bashkëpunimi korrekt dhe me vlerë për hetimet me zyrën e S.P.M.T.Sh.I në Prokurorinë e Përgjithshme.

Duhet evidentuar fakti, se në lidhje me korespondencat, transkriptimet, apo administrimin e CD-ve, është krijuar një praktikë e mirë.

Për çdo rast evidentohet saktë në regjistrin përkatës të përgjimeve.

Për këtë ka shërbyer dhe udhezimi i Prokurorit të Përgjithshëm “Për përgjimet”.

Dhe me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë, ka patur një bashkëpunim korrekt, por këtë vit nuk ka patur një numër të konsiderueshëm praktikash.

ADMINISTRATA

Në mbarëvajtjen e punës të veprimtarisë së Prokurorisë një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e Prokurorisë.

Duhet evidentuar se sa i përket zyrës së regjistrimit rezulton se janë mbajtur me korrektësi regjistrat përkatës, janë dërguar brenda afateve të percaktuara evidencat.

Zyra e K/sekretarisë ka përballuar volumin e protokolleve si dhe mbajtur evidencat financiare.

Rezultoni se tashmë ka një ngarkesë sa i përket kësaj zyre, për shkak të mbulimit të tre sektorëve, si të protokullit, financës dhe Arshivën e Prokurorisë, e cila tashmë ka një sistem të rregullt të evidentimit të dosjeve.

DREJTIMIT DHE PRIORITETET E PUNËS PËR VITIN 2021.

Bashkëpunimi ndër-institucional me të gjitha agjensitë ligjzbatuese, të luftës kundër krimit, është një ndër elementët kryesorë të arritjes së suksesit, dhe rezultateve të evidentueshme.

Rritja e nivelit profesional të Prokurorëve dhe Of/pol/Gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme dhe të specializuara, që do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e cilësisë së veprimtarisë hetimore dhe përfaqësimit në gjykime.

Rritja e ushtrimit të kontrollit në dinamikë të çështjeve nga Prokurorët, por dhe kryerja e veprimtarisë hetimore nga ana e tyre.

Vlerësimi i veçantë për çështje të karakterit të rëndësishëm dhe sensitive në mënyrë të diferencuar, duke kryer analiza të vlerësimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lënë detyra konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore.

Prioritetet për vitin në vazhdim 2021 :

Në vështrim të prioriteteve të shpallura nga Keshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, bazuar në progres raportet dhe rekomandimet e partnerëve të huaj, si urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, duhen përcaktuar dhe prioritetet për vitin 2021 si me poshtë :

- Angazhimi maksimal për hetimin dhe përfundimit e çështjeve të mbartura nga vitii 2020.
- Lufta kundër korrupsionit, dhe krimit ekonomiko-financiar, si një nga prioritetet dhe detyrat parësore, të punës tonë, dhe kërkesave të kohës.
- Evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara apo të evidentuara kryesisht, që lidhen me veprimtari korruptive, apo dhe të shpërdorimit të detyrës, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore.
- Rritja e efikasitetit të ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autoreve, që dyshohen për vepra penale të natyrës së trafikeve dhe pastrimit të produkteve, e cila duhet kordinuar me shërbimet e policisë dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese.
- Rritja e integritetit dhe pamvarësisë së Prokurorëve dhe Of/Pol/Gjyq, duke synuar përmirësimin e veprimtarisë, dhe motivimit tyre.

Duke ju falenderuar,

DREJTUESI I PROKURORISË

ARTAN SHTRUNGZA